



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE
Departamenti i Biologjisë

Vlora Ejupi Dina

Titulli i punimit:

**FLORA VASKULARE MATYRORE DRUNORE DHE
SHKURRORE NË PELLGUN E LUMIT MIRUSHË**

Punim i Masterit

Prishtinë, 2026



UNIVERSITY OF PRISHTINA
FACULTY OF MATHEMATICAL-NATURAL SCIENCES
Department of Biology

Candidate:
Vlora Ejupi Dina

Title:
Natural woody and shrubby vascular flora in the Mirusha River basin

Master Thesis

Prishtinë, 2026



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMETIKE-NATYRORE
Departamenti i Biologjisë

Kandidat:
Vlora Ejupi Dina

Titulli i punimit:
**Flora vaskulare natyrore drunore dhe shkurrenë në Pellgun e lumit
Mirushë**

Punim i Masterit

Mentor:
Prof. Dr. Elez Krasniqi

Prishtinë, 2026

11. REZYME

Qëllimi i realizimit të këtij punimi është njoha, përcaktimi respektivisht evidentimi i llojeve bimore drunore dhe shkurre në kuadër të pellgut të lumit Mirushë.

Pellgu i lumit Mirushë, shtrihet në territore kadastrale të komunave Malishevë, Klinë, Suharekë dhe Rahovec. Gjëndet pothuajse në qendër të Kosovës dhe është pjesë e sistemit lumor të Drinit të Bardhë. Zona ka gjeologji dhe pedologji me tipe të ndryshme të shkëmbinjve dhe të tokave. Klima është kontinentale.

Pellgu i Lumit Mirushë karakterizohet me një diversitet biologjik. Flora dhe vegjetacioni i pellgut është mjaft i pasur dhe interesant. Këtë diversitet si pasuri e trashëgimisë natyrore e Kosovës e mundësojnë kushtet gjeologjike, pedologjike dhe klimatike.

Se diversiteti bimor në veçanti ai floristik në pellgun e lumit Mirushë është mjaft i pasur, përmendet edhe në hulumtimet paraprake të autorëve Rexhepi, F. 1994, Krasniqi, E. 2003, Krasniqi, E. etj. 2012).

Është një përzierje e ekosistemeve dhe habitateve të ndryshme në kuadër të pellgut të lumit Mirushë e cila ka në tërësinë e saj diversitet bimor interesant me florë dhe vegjetacionin përgjatë rrjedhës së lumit Mirushë dhe rrjedhave tjera ujore, në livadhetë ultësirave dhe kullosa, në pyje dhe shkurre të zonës kodrinore-malore, me florë dhe vegjetacion ruderal dhe poashtu atë të agroekosistemeve.

Rrjedha e lumit Mirushë, si zone më e ulët, dhe rrjedhat tjera ujore është interesante nga se në ato zona gjenden pyje e shkurre me *shelgu* (*Salix*) e nganjëherë edhe me prezencë të *plepit* (*populus*) dhe llojeve tjera bimore të cilat rriten në ato habitate. Në aspektin fitosociologjik, sipas metodologjisë së hulumtimit të vegjetacionit bazuar në Braun Blanquet 1964 (Rexhepi, F. 1994), këto pyje rangohen në klasën *Quercus-Fagetea*. Ka zona të vogla edhe me *verr të zi* (*Alnus glutinosa*) sipas metodologjisë së lartpërmendur i takon klasës *Alnetea glutinosae*.

Zona kodrinore deri te ajo malore mbulohet nga pyjet gjetherënëse. Ato dominohen nga llojet e *dushkut* (*Quercus*). Poashtu, afër vendbanimeve dhe agroekosistemeve shtrihen fragmente me shkurre ku gjendet me shumicë *kulavria* (*Prunus spinosa*) dhe llojeve tjera bimore që zakonisht rriten në ato habitate. Të dy këto tipe të vegjetacionit në rangimin fitosociologjik sipas Rexhepi, F. (1994) i takon klasës *Quercus-Fagetea*.

Nëpër ultësira shtrihen livadhet (livadhet e ultësirave). Nëpër ato ultësira kalon Lumi Mirushë dhe rrjedhat tjera ujore. Flora dhe vegjetacioni i livadheve është poashtu interesant në aspektin e biodiversitetit në përgjithësi ku flora ka rol me rëndësi. Ky tip i vegjetacionit në aspektin fitosociologjik (Rexhepi, F. 1994) i takon klasës *Molinio-Arrhenatheretea*.

Edhe kullosat edhe pse fragmentare, janë mire të mbuluara nga diversiteti bimor. Afër vendbanimeve shtrihet bimësia ruderale dhe ajo e agroekosistemeve duke u shtrirë në sipërfaqe të konsiderueshme.

Në kuadër të pellgut të lumit Mirushë jo trallë gjenden grupe të vogla të individëve bimor ose Individë të vetmuar të llojeve të caktuara bimore drunore dhe shkurre, të cilët janë fakte që tregojnë për të kaluarën e bimësisë në pellg.

Aktivite njerëzore s'kurr në pothuaj se tërë territorin e Kosovës, edhe në territorin e pellgut të lumit Mirushë janë evidente përfshirë poashtu ekosistemet dhe habitatet të cilat janë të populluara me lloje bimore drunore dhe shkurre.

Ndër faktorët të cilët ndikojnë negativisht në diversitetin bimor të pellgut janë: ndryshimi i denstimit të sipërfaqes (nga pylli në arë), zgjerimi i vendbanimeve, shfrytëzimi i drurit për. Si pasojë e këtij presioni antropogjen në raport me mjedisin, shfaqen veprime negative të cilat ndikojnë edhe te bimët drunore dhe shkurre. Prandaj është e rëndësishme marrja nën mbrojtje ligjore e disa biomonumenteve natyrore të zonës nga organet shtetërore (MMPHI).

Fakt tjetër me rëndësi është edhe vlerësimi sipas kriterëve të IUCN në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës me qëllim mbrojtjen me ligj të tre nga llojet bimore nga format jetësore drunore respektivisht shkurre të cilat gjenden në pellgun e lumit Mirushë (*Forsythia europaea*, *Malus Florentina*, dhe *Quercus robur*. (Millaku, F. etj. 2013).